




REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME  
Nr.01-060/01-22773/24 datë:22.08.2024



Npi – 01/289 datë: 30.08.2024

Bazuar në nenin 12.2 shkronja (d), nenin 62.1 dhe 66.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008); Nenin 54.4 dhe 56.2 të Statutit të Komunës së Shtimes Nr.01-06/1636, të datës 03.09.2008; Kuvendi Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më: 30.08.2024, mori këtë:

V E N D I M

PËR NUMRIN DHE EMËRTIMIN E DREJTORIVE TË KOMUNËS SË SHTIMES

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VIII- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 30.08.2024, unanimisht miratoi, numrin dhe emërtimin e Drejtorive të Administratës të Komunës së Shtimes si vijon:

1. Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, (DAP)
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa, (DBF)
3. Drejtoria Komunale për Arsim, (DKA)
4. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, (DSHMS)
5. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, (DZHE)
6. Drejtoria për Shërbimeve Publike, (DSHP)
7. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, (DKRS)
8. Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, (DBZHR)
9. Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, (DPUKGJ)
10. Drejtoria për Inovacion dhe Zhvillim të Projekteve, (DIZHP)
11. Drejtoria për Prokurim Publik. (DPP)

II

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe publikimi në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit  
Adnan Ademi